



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA**

**KUVENDI / SKUPŠTINA /ASSEMBLY**

---

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut , Barazi Gjinore,  
Personat e Pagjetur dhe Peticione  
Prishtinë me 27 shkurt 2008 në orën 13,00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**P R O C E S V R B A L**

**i mbledhjes se Komisionit për të Drejtat e Njeriut ,Barazi Gjinore,  
Personat e Pagjetur dhe Peticione**

Në mbledhje morën pjesë : Ismet Beqiri, kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujović, Nerxhivane Dauti, Naim Rustemi, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Vezira Emrush, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati anëtarë.

Mbledhjen e kryesoi Ismet Beqiri -kryetar dhe propozoi këtë ;

**REND DITE**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes se kaluar,
2. Hartimi i planit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2008,
3. Të ndryshme

Rendi i ditës u miratua .

U hap shqyrtimi për pikën e parë

- 1 Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**  
Pasi nuk pati vërejtje ai u miratua

## 2 Hartimi i planit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2008

**Ismet Beqiri**, kryetar pasi i përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe u dëshiroi mirëseardhje, shtoi : Para jush keni një draft që kërkohet të plotësohet e pastaj të miratohet. Sipas tij kjo do të plotësohet dhe kërkoi nga sekretaria të sigurohen raportet nga ish- legjislatura për ato fusha që i mbulon Komisioni. Ai propozoi të ftohej kryesuesi i Nënkomisionit për peticione e ish- legjislaturës së dyte dhe për se afërmi të na njoftojë për punën që është kryer. Ne vazhdim i ceku disa pika të planit të punës që do zënë vend si : nisma për hartimin e Projektligjit për të zhdukurit, vizita që do t'u behet institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, presidentit, kryeministrit, kryetarit të Kuvendit etj. Lidhur me këtë pikë hapi debatin.

**Hajredin Hyseni** – u pajtua me parafolësin dhe shtoi : Ka nevojë të monitorohet zbatimi i Ligjit për barazi gjinore dhe njëkohësisht propozoi, krahas se nismës për hartimin e Projektligjit për të zhdukurit, të përfshihet edhe Projektligji për lejimin e protestave .

**Ibrahim Makolli**- duke u ndërlidhur me parafolësin shtoi: Puna jone do të ishte monitorimin i zbatimit të ligjeve në praktike në fushën e të drejtave të njeriut, të barazisë gjinore, personat e pagjetur dhe peticione. Ai me tutje shtoi : I lidhur jam ngushte me fushën e të drejtave të njeriut dhe kërkoi që në strategji të parashihet ndjekja e atyre që kanë kryer krime gjate luftës, duke kërkuar kontakt me prokuroritë për të marre informata lidhur me kallëzimet e ngritura penale . Ai për zvarritjen dhe për mos procedimin tyre tha ishin pasoje pengesa burokratike . Ai propozoi që në planin e punës të përfshihen monitorimi i disa ligjeve si p.sh. Ligji i konsumatoreve, ligji i punës etj. Në fund ngriti shqetësimin e të burgosurve dhe propozoi të vizitohen Dubrava dhe Lypjani. A pastaj foli për arsimin etj.

**Drita Maliqi** - u pajtua me parafolësin dhe shtoi : Do të ishte e nevojshme që Komisioni të informohej për punën e legjislaturës së dytë në fushat që i mbulohen.

Ajo i propozoi Komisionit të vizitohej Bosnja dhe të informohej Komisioni me përse afërmi për me problemet që ata kanë përvojë ,pra të vizitohet Tuzlla, ku do njoftoheshim për laboratorin e mostrave të ADN-së.

**Sanije Alijaj** –Duke u ndërlidhur me parafolësin,sa u përket personave të pagjetur shtoi : se Komisioni ka nevojë për nisma të tilla dhe sugjeroi : Komisioni para se të miratohet plani i punës të ftojë Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur dhe ta kemi një takim në të cilin do të ofrohen informata për punën që është bërë deri tani. Propozimi i sajë u mirëprit nga të pranishmit . Ajo diskutoi edhe për çështje të tjera që bien në fushën e Komisionit .

**Luljeta Shehu** – ishte e pajtimit me parafolësin Ajo vuri në pah dallimin që ekziston në mes familjeve të dëshmorëve dhe të të zhdukurave në realizimin e se drejtës së pensionit . Ky dallimi është madhe dhe ka shkaktuar shqetësime të familjet e të zhdukurave ,prandaj , nisma për hartimin Projektligjin për personat e pagjetur u mirëprit .,

**Naim Rrustemi** u pajtua me parafolësin dhe shtoi : Takimet të ndahen në katër fusha Ai u pajtua që bartësit e propozuar, lidhur me punën, kryer ta informojnë Komisionin .

Në fund tha se kontributin do të jepte në fushën e barazisë gjinore pasi është anëtarë i grupit strategjik në Qeverinë Republikës së Kosovës. Pastaj serish diskutuan deputetet : Sanije Alijaj dhe Ibrahim Makolli

**Ismet Beqiri** në fjalën e serishme i propozoi Komisionit që t'i ngarkoi disa anëtarë të cilët e njohin fushën përkatëse dhe lidhur me këtë nxori :

## **P ë r f u n d i m**

### **1 Për formimin e grupeve punuese në fushat përkatëse, me këtë përbërje .**

- 1 Ibrahim Makolli, për të Drejta e Njeriut ,*
- 2 Hajredin Hyseni, për Barazi Gjinore dhe*
- 3 Nerxhivane Dauti, për Peticione*
- 4 Sanije Alijaj, për Persona të Pagjetur .*

**2.** Komisioni do të informohet nga anëtarët, lidhur me punën e kryer. Me këtë përfundim do të njoftohen anëtarët e Komisionit Komisioni e miratoi propozimin .Ata u zotua që secili do të kontribuojë për fushën përkatëse

**Vezi Emrush** – duke u ndërlidhur me parafolësit shtoi : se liritë dhe te drejtat e njeriut nuk po respektohen sa duhet në Republikën e Kosovës dhe insistoi të kontaktohet me Këshillin për Liritë dhe Drejtat e Njeriut të themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr 2006/12 dhe të informohemi më për se afërmi. Me tutje nënvizoi se këto të drejta janë të garantuara me Kartën Universale të OKB-së të miratuar në vitin 1948 , si dhe konventat e europiane që i mbrojnë liritë dhe të drejtat e njeriut . Ajo pastaj foli edhe për fushat të tjera që mbulohen nga Komisioni.

### **3 Të ndryshme**

Komisioni vendosi para se të miratohej planin i punës të ketë një takim të përbashkët me subjektet të shënuar me poshtë dhe lidhur me këtë nxori:

## **P ë r f u n d i m**

- 1. Të ftohet nga një anëtar nga Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Pagjetur, Komisioni Qeveritar për Personat e Zhdukur, z. Pajazit Nushi dhe znj. Flora Brovina*

Mbledhja përfundoi në orën 15,30

Procesverbalin e hartoi  
Rrahim Demaj – zyrtar i lartë

Kryetari i Komisionit  
Ismet Beqiri